



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Mbledhje e përbashkët

*Këshilli për Legjislacionin dhe Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike
dhe të Drejtat e Njeriut*

PROCESVERBAL

Tiranë, më 19.10.2018, ora 10:00

Drejton mbledhjen:

Gramoz Ruçi – Kryetar i Kuvendit

Rendi i ditës:

1. Seancë dëgjimore me përfaqësues nga bota akademike lidhur me shqyrtimin e projektligjit “Për një ndryshim në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998 “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar”.

Marrin pjesë:

Gramoz Ruçi, Ulsi Manja, Klotilda Bushka, Bledar Çuçi, Alket Hyseni, Edmond Leka, Spartak Braho, Elena Xhina, Xhemal Qefalia, Arben Pëllumbi, Luçiano Boçi

Mungojnë:

Enkelejd Alibeaj, Vasilika Hysi, Bashkim Fino, Adnor Shameti, Ermonela Felaj, Jurgis Çyrbja, Oerd Bylykbashi, Gent Strazimiri, Dhurata Çupi, Astrit Veliaj, Fatmir Mediu, Nasip Naço, Tom Doshi, Silva Caka, Edmond Haxhinasto.

Të ftuar:

Artan Hoxha – Dekan në Fakultetin e Drejtësisë në UT

Ermir Dobjani - Pedagog në Fakultetin e Drejtësisë në UT

Kestrin Katro - Pedagoge në Fakultetin e Drejtësisë në UT

Erjon Muharremaj - Pedagog në Fakultetin e Drejtësisë në UT

Enkeleda Olldashi - Pedagoge në Fakultetin e Drejtësisë në UT
Evis Alimehmeti - Pedagoge në Fakultetin e Drejtësisë në UT
Zhaklina Peto - Pedagoge në Fakultetin e Drejtësisë në UT
Erind Merkuri – Pedagog në Fakultetin e Drejtësisë në UT
Adea Pirdeni - Pedagoge në Fakultetin e Drejtësisë në UT
Fjorda Shqari - Pedagoge në Fakultetin e Drejtësisë në UT
Nadia Rusi - Pedagoge në Fakultetin e Drejtësisë në UT
Ledina Mandija – Pedagoge në Universitetin Europian të Tiranës
Rezana Konomi – Dekane në Kolegjin Universitar “Luarasi”
Aleksander Muskaj - Pedagog në Kolegjin Universitar “Luarasi”
Dorina Gjipali - Pedagoge në Kolegjin Universitar “Luarasi”
Alba Kucani – Pedagoge në Kolegjin Universitar “Luarasi”
Ernest Balili – Pedagog në Kolegjin Universitar “Luarasi”
Elona Bano - Pedagoge në Universitetin “Marin Barleti”
Ksenofon Krisafi – Dekan në Universitetin Mesdhetar të Shqipërisë
Kosta Gazeli - Pedagog në Universitetin Mesdhetar të Shqipërisë
Hektor Ruci – Pedagog në Universitetin “New York Tirana”
Naim Mëçalla – Dekan në Universitetin “Wisdom”
Arben Malaj – President Nderi në Institutin për Politikat Publike dhe Mirëqeverisjen

HAPET MBLEDHJA

Gramoz Ruçi – Përshëndetje! Atëherë le të fillojmë!

Të nderuar pjesëmarrës të këtij takimi,

Së pari ju falënderoj që i jeni përgjigjur pozitivisht ftesës që u ka bërë institucioneve akademike Kuvendi i Shqipërisë, për një tur që ka filluar, nga një nismë deputetësh, lidhur me ndryshimet kushtetuese. Komisioni i Ligjeve dhe Këshilli i ri i Legjislacionit kanë bërë një program në lidhje me këtë çështje. Në kuadër të këtij programi, një nga tryezat e tërheqjes së mendimit për këtë nismë është bota akademike. Ky që po zhvillojmë është takimi i dytë. Çdo javë do të ketë tryeza të tilla edhe me universitetet nëpër rrethe.

Kësisoj, pa humbur kohë, mendoj të fillojmë mbledhjen.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Do ta merrni fjalën për procedurë, vetëm shkurt!

Luçiano Boçi – Po. Faleminderit!

Së pari, dua të falënderoj përfaqësuesit e botës akademike, të cilët i janë përgjigjur thirrjes së Kuvendit për këtë seancë dëgjimore, por dua të theksoj se, ashtu si dhe në seancën e kaluar me shoqërinë civile, edhe me botën akademike, vihet re një abandonim i seancës dëgjimore.

Unë kam këtu listën e institucioneve të arsimit të lartë, që kanë dërguar përfaqësuesit e tyre, dhe numri i përfaqësuesve të këtyre institucioneve është vetëm shtatë, ndërkohë që institucionet e arsimit të lartë në Shqipëri janë gjithsej gjashtëdhjetë e gjashtë. Pra, i bie më pak se dhjetë për qind.

Në fakt, nisur edhe nga seanca e mëparshme me shoqërinë civile, siç e theksova, por edhe kjo e botës akademike, ka një lloj paragjykimi nga shoqëria në lidhje me këto seanca. Ka paragjykim, sepse në fakt është një lloj demonstrimi i një konkluzioni logjik, pasi tashmë dihet se maxhoranca, siç ka qejf ta thotë Kryeministri, është shprehur me zë dhe figurë, që parimisht nuk e pranon vetëgjuhën politik as në formë, as në përmbajtje e as në ndryshime kushtetuese apo ligjore.

Me sa shoh unë, kjo maxhorancë, që duket dhe është shumë e vendosur të sjellë në Kuvend ligje speciale, ligje të cilat nuk konsultohen fare as me grupet e interesit dhe as me

publikun, kërkon që diskutimin për ndryshimet kushtetuese ta fusë në kalendrat greke, ose sipas parimit që, kur nuk duhet ta zgjidhësh një punë apo një çështje, bëj mbledhje pa fund në lidhje me atë punë e atë çështje. Në fakt kjo gjë po ndodh edhe me seancat dëgjimore. Sigurisht, unë do të thosha, nisur përsëri nga dëgjesa e parë, por edhe nga kjo, nisur nga atmosfera që sundon... E dini si është kjo atmosferë? Është pak a shumë si atmosfera e atyre dasmave, të cilat bëhen kur çifti, për shkak të refuzimeve, ka lindur vajzën dhe pastaj bën dasmën, duke thërritur në dasmën e tyre këdo që u del përpara. Në fund të dasmës, fajin që lindi vajzë s'e ka asnjëri nga çifti, por e kanë të ftuarit.

Këtë po kërkon të bëjë edhe maxhoranca, kërkon që verdiktin e saj, vendimin e saj për të mos i pranuar ndryshimet kushtetuese, të cilat i hapin rrugë vetingut politik, t'ia hedhë fajin pjesës së dëgjesave: botës akademike, shoqërisë civile. Normale, sepse mendimet janë diverse dhe është e natyrshme të jenë të tilla, por unë do të gjykoja se krahas shoqërisë civile, në qoftë se ka një botë që e ndjen më shumë ndikimin e krimplotikës në Shqipëri, nisur nga fakti se edhe vetë jam pjesë e saj, kjo është bota akademike.

Tashmë ju e dini shumë mirë, të gjithë ne e dimë shumë mirë, se krimi i veshur me veladonin e politikës apo politika e pajisur me agresivitetin e krimit ka kapërcyer kangjellat e universiteteve, ka shpërthyer portat e universiteteve dhe ka marrë peng jo vetëm procesin e zgjedhjeve në universitete, por edhe procesin e emërimeve në universitete, ka kapur dhënien e doktoraturave, dhënien e titujve, dhe një formalizëm, që të gjithë e pranojmë këtë dhunë politike e kriminale, por nuk bëzajmë.

Ja ku jemi sot, pikërisht me këtë kërkesë emergjente të shoqërisë shqiptare, por sidomos të botës akademike, për ta nxjerrë krimin nga politika, për të mos e kriminalizuar politikën. Iniciativa jonë është e qartë, e thjeshtë dhe pa ekuivoke. Kërkojmë të bëhen ndryshime kushtetuese, për të bërë atë që shoqëria kërkon: vetingun e politikës.

Të dashur pjesëmarrës,

Ju e dini shumë mirë që, në qoftë se vetingu në drejtësi pranohet nga publiku, në një pjesë të madhe të argumenteve që jepen për pranueshmëri nga publiku, është së ky veting do të çojë në vetingun e politikës. Nuk është vetëm çështja e drejtësisë ajo që në këtë rast intimidon publikun dhe iniciativat politike, por mbi të gjitha është vetingu i politikës, e drejta e politikës, e sidomos drejtësia sociale.

Unë, personalisht, e kam shprehur se ka një lloj skepticizmi, për shkak se tashmë është përdorur një metodë inverse. Këtu ka përfaqësues të Fakultetit Juridik, të cilët e dinë shumë mirë se kërkohet që, nëpërmjet drejtësisë juridike, drejtësisë së drejtësisë, të vendoset drejtësia politike ose drejtësia sociale. Por, në fakt, kush është ai që e beson se nga një drejtësi politike e deformuar e kriminalizuar, një zhdrejtësi politike, mund të prodhohej një drejtësi e drejtësisë, e drejtë? Nuk besoj se ka iluzione në këtë pikë dhe, në fakt, edhe ata që merren me doktrinat e zhdeformimit e dinë shumë mirë që thelbi i sistemit demokratik është politika e drejtë, drejtësia politike. Pa drejtësi në politikë, pa të drejtën e votës, nuk mund të kemi pushtetet e tjera që, duam s'duam ne, burojnë nga politika, dhe në qoftë se burimi është i ndotur, në qoftë se burimi është i kriminalizuar, çfarë produkti do të dalë? Çfarë do të dalë nga ekzekutivi që, në fakt, është inkriminuar?

Ku e kemi sot parlamentin, me fakte, i inkriminuar? Ne duhet të besojmë se sistemi i drejtësisë, që do të dalë, nuk do të jetë i kapur nga kjo politikë e kriminalizuar? Ky është iluzion. Prandaj, kërkesa jonë është e thjeshtë: hajde së bashku të bëjmë atë që e kërkon gjithë publiku, që ka pranuar edhe vetingun në drejtësi dhe e kërkon në drejtësi. Të bëjmë vetingun e politikës, që është gjëja më e thjeshtë, është detyra jonë. Ne që bëjmë teorira të ndryshme për korrupsionin, dhe ky është propozimi ynë i sigurtë dhe i vërtetë, ta nisim nga vetja. Prandaj kërkojmë që t'u hapen rrugë ndryshimeve kushtetuese. Nuk kërkojmë asgjë më shumë se sa kaq.

Gramoz Ruçi – Ju lutem, t'i respektojmë kolegët! I kemi thirrur jo të na dëgjojnë këto neve, por ne ata ...

Luçiano Boçi – Dakord, por ka një gabim konceptual këtu, zoti Kryetar, se vërtet është dëgjuesë, por në dëgjuesë janë dy palë që dëgjojnë njëra-tjetrën, pra, që edhe flasin njëkohësisht.

Në qoftë se do të ishte me një drejtim, atëherë ...

Gramoz Ruçi – Ju lutem, më thatë për procedurë. Çfarë keni për procedurë?

Luçiano Boçi – Për procedurë unë kërkoj që këto seanca të mos zgjaten, të mos zvarriten, sepse duket që kanë karakter krejtësisht formal dhe kanë një qëllim të mbrapshtë. Çfarë vlere ka kjo seancë, kur kemi 66 institucione të arsimit të lartë dhe këtu janë vetëm 7 të pranishëm (nuk e di a janë 7) të ulur në tavolinë, sepse lista këtu është me 24 persona, në fakt, por janë 7 institucione të arsimit të lartë. Çfarë efikasiteti ka? Ku është mendimi i botës akademike, sepse, të paktën, është koncepti i kuorumit dhe ne duhet të marrim mendimin e tyre, por, në qoftë se ne vijmë këtu me 10%, dhe unë e di se pedagogët kanë ardhur me iniciativën e

tyre, janë të atashuar nga drejtuesit dhe, fatkeqësisht, ne sot nuk kemi përfaqësues në nivelin e rektorit, kemi në nivel dekani, se është dekani i Fakultetit të Drejtësisë. Në nivel rektori nuk ke asnjë përfaqësim. Pra, ka neglizhencë, sepse është e paragjykuar, sepse vendimi është marrë, sepse Kryeministri e ka shprehur, prandaj unë bëj thirrje: “Stop këtyre seancave formale!”. Këto janë tërësisht formale. Janë si faji i vajzës që lindi vajzë për çiftin e politikës së martuar me krimin. Fajin nuk e ka politika dhe nuk e ka as krimi, se ato u njohën dhe ranë në dashuri me njëri-tjetrin, por e kanë dasmorët, që ne i kemi kapur gjatë rrugës. Kjo është e turpshme. Kjo nuk mund të vazhdojë dhe në fund të dilet më konkluzione të tilla. Prandaj, ne duam dhe kërkojmë nga ju t’i jepni fund këtij teatri, sepse e keni zhvendosur, meqenëse po prishni teatrin me ligj special, të pakonsultuar fare as me botën akademike, që duhej ta bënit, se është ligj special ai. Për propozimet tuaja nuk bëni seanca dëgjimore ju, kurse për propozimet e opozitës për veting politik i fusni në kalendat greke, në diskutime pa fund.

Ligji special që shemb trashëgiminë kulturore është ai ligj që nuk u diskutua kurrë me këta burra dhe gra të nderuara që janë këtu, apo përtej...

Gramoz Ruçi - Faleminderit!

Luçiano Boçi – Teatrin e keni zhvendosur këtu...

Gramoz Ruçi – Ju lutem, lëre teatrin tani...

Luçiano Boçi – Ju lutem shumë, nuk jemi këtu për të bërë teatër dhe nuk jemi këtu për të bërë hipokrizinë e radhës nga ana e maxhorancës. Ne duhet të jemi politikanë seriozë në bazë të votëbesimit që na kanë dhënë votuesit. Ne marrim iniciativa politike për të marrë vendime politike, në radhë të parë, vendime politike që ushtrojnë të drejtën e kontrollit të publikut dhe vetingut politik te politika.

Pa bërë katarsis në veten tonë nuk mund të kërkojnë katarsisin e sistemeve të tjera, se është absurde dhe krejtësisht e papranueshme.

Prandaj, zoti Kryetar, ne duam që me iniciativën tonë t’i vëmë kufirin te thana krimit në politikë...

Gramoz Ruçi – Të lutem, mos më detyro të të pres fjalën...

Koha juaj për procedurë ishte 3 minuta. Kjo është procedura parlamentare, prandaj, ju lutem... jua kam prerë fjalën...

(Diskutime pa mikrofon)

Të nderuar përfaqësues të botës akademike,

Po ju njoh me programin, në përgjigje edhe të asaj çka shtroi kolegu. Unë, edhe një herë, ju falënderoj për prezencën tuaj këtu. Pjesëmarrja ka qenë e lirë. Ne u jemi drejtuar institucioneve, që ju përfaqësoni dhe ju e keni menduar të arsyeshme për të ardhur.

Faleminderit shumë!

Faleminderit edhe atyre që s'e kanë menduar të arsyeshme për të ardhur! Ne nuk mund të bëjmë listë dhe ju nuk përbëni kuorum. Kuorum përbëjmë ne dhe po të jetë për kuorum, shikoni pjesëmarrjen, të nderuar kolegë, ndërsa nga njëri grup pothuajse janë të gjithë, nga grupimi tjetër është vetëm një. Ky është kuorum. Ky është serioziteti dhe kjo është përgjegjësia për nismën që kemi marrë.

Së dyti, pavarësisht numrit të madh, ju duhet ta dini, por edhe ju të nderuar pjesëmarrës, që ne nuk kemi ftuar këtu sot në këtë takim universitetet e rretheve, pasi e kemi parë të arsyeshme të shkojmë ne atje. Në kalendarin që ka bërë komisioni, kanë lënë takime në Shkodër, në Elbasan, në Universitetin e Korçës, në mos gaboj dhe atë të Vlorës, me qëllim që të shkojë komisioni tek ata dhe jo të vijnë ata këtu. Pra, nuk ka vend për ta trajtuar as si abandonim, as ndonjë seleksionim, as mospërfillje për këtë çështje. Retorikë politike pastaj: se ka thënë Kryeministri, nuk ka thënë Kryeministri, ju lutem, se këtu jemi në Kuvendin e Shqipërisë dhe Kuvendi duhet të bëjë procedura strikte sipas Kushtetutës dhe sipas Rregullores. Ne jemi duke e zbatuar. Ky është vlerësim për nismëtarët që komisioni mbledhet në mënyrë periodike, sipas Rregullores së Kuvendit, sipas Kushtetutës, sipas praktikave më të mira që ka Kuvendi kur bëhen ndryshime kushtetuese. Veç konsultimeve ne i jemi drejtuar edhe Komisionit të Venecies dhe sikurse thuhet këtu: që zvarritet. Jo, nuk ka fare zvarritje, por nuk duhet të ketë as ngutje, se bëjmë ndryshime kushtetuese. Një projektligj i zakonshëm, një nen i zakonshëm, një përmirësim i një neni, i një ligji, minimumi i minimumit nuk mund të shqyrtohet pa kaluar 3 javë, aq më tepër kur bëhet fjalë për ndryshimet kushtetuese.

Prandaj, të mos humbasim kohë. Ne kemi kohë të debatojmë si anëtarë të Komisionit për Këshillin e Legjislacionit dhe Komisionit të Ligjeve. Sot jemi në ditën që duhet të dëgjojmë të ftuarit. Jeni të lirë, secili mund të prezantohet dhe të japë mendime, siç i mendon. Të mos humbasim kohën e tyre të çmuar.

Luçiano Boçi - Kam një sqarim të fundit në lidhje me pjesëmarrjen e botës akademike, meqenëse këtu po bëhet polemikë numrash, atëherë shumë mirë nga 66 institucione të arsimit të lartë, po ju heq 6 të rretheve, mbeten 60. Këtu keni gjithsej 7.

Gramoz Ruçi - Dakord.

Luçiano Boçi – Pra, e rritëm 1% pjesëmarrjen, por nuk gjykoj se ky është mendimi total i botës akademike. Respekte për praninë e botës akademike.

Gramoz Ruçi - Unë jam që të shtojmë seancat dëgjimore. Bëni propozimet dhe unë jam dakord.

Luçiano Boçi - Po, sigurisht. Ju këtë punë do të bëni, sepse doni ta shtyni 3 javë. Kur doni ju një ligj e fusni nën tavolinë, e votoni brenda ditës, sepse janë ligje speciale dhe janë me shembje, me miliona euro, kurse ky është vetting politik, që sigurisht ju dëmton. Shumë respekte për botën akademike! Por unë në këtë rast duke përfaqësuar opozitën, do të kisha shumë dëshirë, të dëgjoja mendimet e tyre. Në fakt, nuk është se nuk do të jem në kontakt me vendimet e tyre, do t'i marr ato, sepse ka mënyra alternative për t'i marrë ato, por nuk mund të jemi prezent në një farsë të sajuar në këtë lloj forme dasme ku dasmorët nuk qeshin dot.

Faleminderit!

Gramoz Ruçi – Është e drejta juaj.

Urdhëroni, të nderuar pjesëmarrës! Kush e dëshiron fjalën?

Erind Mërkuri – Përshëndetje!

Jam lektor i të Drejtës Kushtetuese në Fakultetin e Drejtësisë, në Universitetin e Tiranës.

Në lidhje me propozimin, në formatin që na është paraqitur me postë elektronike, e para e punës për natyrën e vetingut, vetingu është i rrallë në gjyqësor, në politikë është akoma dhe më i rrallë si fenomen. Përgjithësisht, nga modelet që kemi studiuar aplikohet në rastet kur përzgjidhen kandidatura që të jenë sa më të pastra në sytë e publikut për shkak të sulmeve politike që mund të bëhen. Për shembull një rast vetingu i bërë gabim është ai i kandidatës për zëvendëspresidente Sara Palin në zgjedhjet presidenciale amerikane, para dy legjislatrave atje. Pra, u mendua se u bë me shpejtësi, nuk u kap në kohë dhe asaj i dolën shumë probleme gjatë rrugës. Pra, më shumë është parë si një nocion i përzgjedhjes së kandidaturave se sa i vetë politikës, por megjithatë nëse Kuvendi do ta vlerësojë, ta miratojë, sepse është në vullnetin e Kuvendit kjo pjesë, nuk i përket mendoj botës akademike që ta vlerësojë.

Unë do të thosha se projekti paraqet disa problematika në këtë aspekt, që ndoshta edhe mund të përmirësohen. Për shembull, te subjektet nuk përfshihen këshilltarët bashkiakë, anëtarët e këshillave bashkiakë janë të përjashtuar, ndërkohë që të gjithë të zgjedhurit e tjerë synojnë

të futen në një sitë për t'u parë. Këta të zgjedhur të tjerë, që janë të zgjedhur të popullit nuk janë përfshirë në atë pjesë. Mendoj se ka një mangësi në lidhje me strukturën: kush do t'i hetojë “deputetët? Vetingu i gjyqësorit e kishte në vija të përgjithshme të detajuar me ligj. Pse e themi këtë? Nuk mund t'i emërojë Kuvendi. Nëse do të zgjidhet, jam i mendimit se nuk mund t'i emërojë Kuvendi, sepse ky i fundit do të hetohet, Kuvendi i emëron, pra është pak nonsens nga ana e konfliktit të interesave, edhe paraqitjes përpara popullit në këtë rast. Mund t'u lihet organeve të pavarura, një zgjedhje e Kuvendit.

Mund të marrim rastin e Serbisë, është vetingu i gjyqësorit, por mund ta bëjmë për analogji: në Serbi vetingun e gjyqësorit e bëri këshilli gjyqësor dhe quhet se dështoi. Pra, ata kontrolluan veten e tyre dhe u konsiderua si dështim. Në këtë rast me analogji mund të themi se edhe Kuvendi nuk mund të bëjë vetingun e vetes së tij.

Për sa u përket hetimeve kemi vetëm për kontakte të papërshtatshme, lind nocioni: çfarë është kontakti i papërshtatshëm? Po, personat që janë në hetim, hetohen, por nuk janë dënuar, sepse standardi kushtetues është pak i lartë në këtë rast. Ne themi person fajtor konsiderohet vetëm ai i shpallur me vendim të formës së prerë, neni 30 i Kushtetutës. Nëse janë persona nën hetim, por nuk janë fajtorë, sepse nuk janë gjykuar, nuk ka mbaruar procesi për një mijë arsye, do të konsiderohet shoqërimi si kontakt i papërshtatshëm? Kjo e lë të diskutueshme.

Një tjetër debat mund të jenë familjarët. Kushtetuta përjashton familjarët nga detyrimi për të dëshmuar dhe nga detyrimi për t'i kallëzuar familjarët e tyre në këtë drejtim. A mund të themi që konsiderohesh i papërshtatshëm për shkak të familjarit, që mund të dalë gjatë hetimit administrativ?

Kam edhe diçka tjetër këtu. Në lidhje me kontaktet e papërshtatshme ka shumë pak raste praktike. Po të shikohet vetingu i gjyqtarëve, për analogji, vetëm 3 raste janë individualizuar si kontakte të papërshtatshme, nga të paktën 66 raste që ka shqyrtuar deri më sot komisioni i shkallës së parë, Komisioni i Pavarur i Kualifikimit. Deri tani vetëm 3 raste rezultojnë si kontakte të papërshtatshme. Të gjitha rastet e tjera nuk kanë rezultuar me kontakte të papërshtatshme, pavarësisht se ka pasur sinjalizime nga DSIK-ja. Pra, duket sikur këtë lloj kontakti, edhe e kap, edhe nuk e kap sita. Në këtë drejtim, nuk parashikohet fare kontrolli i pasurisë. Në qoftë se mendohet që personi, deputeti, i zgjedhuri, kryetari i bashkisë, ministri, kryeministri e të tjerë, janë të lidhur me krimin, në mënyrë të natyrshme do të afektojnë edhe

pasurinë e personit. Nëse në këtë rast do të bëhej një hetim, do të ishte mirë të përfshihej edhe kontrolli i pasurisë.

Një tjetër element është përkohshmëria. Vetingu presupozohet si i përkohshëm në kohë. Mund të japim një afat, 10 apo 20 vjet, kjo nuk ka rëndësi. Pra, është një situatë emergjente ndërhyrjeje në mënyrë të përkohshme. Në këtë kontekst, propozimi nuk parashikon afat, pra duket sikur është i përhershëm. Vetingu synon të rregullojë një situatë anormale, ta kthejë atë në normalitet dhe pastaj janë institucion që operojnë. Të paktën kjo është logjika e vetingut si nocion në këtë rast. Mendoj se po u bë kjo, duhet të përcaktohet një afat. Afati mund të diskutohet se sa mund të jetë.

Teknika legislative është më shumë meraku që kemi për Kushtetutën. Është bërë edhe herë të tjera nga Kuvendi, por, për shembull, nuk mund të shkruhet në nene të veçanta: “Miratohet me 3/5-at”. Kjo nuk ka kuptim, sepse ka një nen të posaçëm kur miratohet me 3/5-at, domethënë, duhet të ruajmë të njëjtën teknikë që është përdorur në ’98-n, sepse po prishim gjuhën me të cilën shkruhet Kushtetuta.

Në vija të përgjithshme, këto ishin çështjet që kisha.

Faleminderit!

Gramoz Ruçi – Faleminderit!

Kush e dëshiron tjetër fjalën?

Urdhëroni!

Më fal, para se ta marrësh fjalën, do të kisha dëshirë të qëndroja, por kam për të takuar ministrin e Jashtëm të Turqisë! Kështu që mbledhja do të vazhdojë nën drejtimin e kryetarit të Komisionit të Ligjeve.

Faleminderit!

Mund të vazhdoni.

Elona Bano – Jam Elona Bano nga universiteti “Marin Barleti”.

Në radhë të parë, ju falënderoj për këtë seancë dëgjimore!

Si juriste dhe pedagoge e të drejtave të njeriut dhe jo vetëm, shoh se kapet një pjesë shumë e rëndësishme, që ka të bëjë me integritetin dhe të drejtën për t’u zgjedhur dhe për të zgjedhur. Si parim, personalisht, jam e mendimit që Kushtetuta nuk mund të ndryshohet çdo 1 apo 2 vjet.

Kam mendimin që këto propozime të jenë pjesë e një ligji tjetër, që tashmë e kemi në fuqi, ligjit nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen dhe ushtrojnë funksione publike”.

Madje, bëra një analizë të shpejtë, për atë që m'u lejua, sepse mbrëmë i kam marrë draftet ligjore dhe po ta vëmë re, propozimi për nenin 176/1, që i thuhet Kushtetutës, pika e parë, është neni 1 i këtij ligji, pra i ligjit nr. 138/2015, ku thuhet: “Objekti i ligjit është mbrojtja, garantimi, mirëfunksionimi demokratik i Kuvendit, i organeve të qeverisjes vendore, institucioneve kushtetuese apo institucioneve të krijuara me ligj”. Po ta lexojmë, është e njëjta gjë, vetëm se është zgjeruar duke futur edhe entitete të tjera, si Forcat e Armatosura apo organet e rendit publik. Pastaj vazhdon me të njëjtën logjikë dhe thuhet: “...nga ndikimi, nga pjesëmarrja në politikëbërje”.

Këtu mungon vetëm ai, që unë e shoh si risinë e gjithë këtij diskutimi: kontakti i papërshtatshëm apo kontakti me krimin e organizuar.

Për mendimin tim, për të ruajtur atë të shenjtin parim të sigurisë juridike dhe mosmodifikimin e Kushtetutës kaq shpesh, sepse prek të gjitha themelet e ligjeve të tjera dhe nuk jeni ju seriozë, në radhë të parë, si të zgjedhurit tanë, dhe nuk jemi ne, si juristë që mundohemi të mësojmë studentët tanë, ne mund të bëjmë një amendament shumë të thjeshtë, qoftë tek objekti, pra te neni 1 i ligjit nr. 138/2015, qoftë te pjesa e subjekteve.

Personalisht, kam pasur shansin të jem pjesë e Sekretariatit Teknik të Reformës në Drejtësi dhe aty diskutimi i madh ka qenë për kontaktin e papërshtatshëm.

I referohem ligjit të fundit, që është nr. 12/2018 “Për vetingun në forcat e policisë”, ku një përkufizim është: “Një takim, komunikim verbal, elektronik apo çfarëdolloj mënyre tjetër”.

Flasim për kryetarë bashkish, flasim për deputetë, të cilët organizojnë mitingje, pra kanë salla masive ku takohen me njerëz dhe mbase nuk e dinë që ata njerëz janë pjesë e krimit të organizuar, sepse ata mund të jenë pjesë e një hetimi. Me sa pashë, vazhdimësia e këtij propozimi është: “Edhe kur kuptohet, do të presumohet dhe individ apo subjekti, që ka kontaktin e papërshtatshëm, ka barrën e provës dhe mund të mos përzgjidhet. Do të ndërpresë detyrën apo do t'i refuzohet detyra, edhe kur ai ka qenë në padijeni.”

Personalisht, edhe si juriste, mendoj që kontakti i papërshtatshëm do një përkufizim më të madh.

Gjykata Europiane të Drejtave të Njeriut ka shumë vendime. Një eksperiencë e mirë është eksperiencia e vetingut në drejtësi, që ne mund ta elaborojmë më tej, sepse edhe një *e-mail*, që dikush mund të dërgojë, apo një telefonatë, ku kandidatit për kryetar bashkie i kërkohet të rregullojë rrugën përpara shtëpisë (rasti më banal) dhe ai person mund të jetë pjesë e një grupi të organizuar dhe ne nuk e dimë, mund të përdoret... Pra, kush do të jenë ata që do ta zbatojnë dhe ata që do të garantojnë, në radhë të parë, integritetin dhe dinjitetin?

Pra, kisha për të thënë vetëm kaq: Kushtetuta, për mua, nuk ka pse të modifikohet, kur tashmë e kemi një ligj. Ka të njëjtat subjekte, të njëjtat parashikime. Mjafton të shtohet pjesa e kontaktit me persona që janë pjesë e krimit të organizuar, por, edhe kjo, kur ka dijeni, sepse personi mund të jetë në hetim dhe ne e dimë që hetimi është sekret dhe nuk mund të paragjykojmë një individ që nuk ka pasur dijeni.

Ju faleminderit!

Ulsi Manja – Faleminderit, zonja Bano, për sugjerimet tuaja!

Do t'ju kërkoja, nëse është mundësia, t'i depozitoni me shkrim komentet dhe sugjerimet tuaja për projektin për ndryshime kushtetuese për vetingun e politikës, të paraqitur nga opozita.

Faleminderit!

Kush e do fjalën?

Zhaklina Peta – Përshëndetje! Jam Zhaklina Peta nga Fakulteti Juridik, Universiteti i Tiranës.

Doja të bëja vetëm një vështrim shumë të shkurtër juridik, në lidhje me disa terma të përdorur në këtë projekt. Do t'i referohem nenit 1, që iu referuan edhe kolegët termit “kontakt me persona të përfshirë në krimin e organizuar”.

Të gjithë e dimë që e drejta për t'u zgjedhur është një e drejtë kushtetuese dhe kufizimi aktual është i qartë. “Dënim për krim të formës së prerë”, më qartë se kaq nuk mund të jetë.

Nisur nga termi, ky nuk është një formulim juridik. Çfarë është kontakti në thelb? Duke lexuar këtë term, të vijnë në mendje një sërë pyetjesh. Si vërtetohet kontakti? Cila është trupa kompetente që do të bëjë verifikimin e këtij kontakti? Si mundet që nga njëra anë përjashtohet nga e drejta për t'u zgjedhur për shkak të një vendimi të formës së prerë dhe nga ana tjetër do të dalë një organ tjetër paralel me këtë dhe të japë një vendim paralel, duke përjashtuar përsëri këtë subjekt nga e drejta për të kandiduar? Kjo nuk bën sens, sepse ka një disproporcion logjik të terminologjisë së përdorur.

Përgjegjësia e çdo individi është një përgjegjësi personale. Nëse në kontakt futen edhe lidhjet familjare, pra duhet të bëhet një analizë e qartë e termit “kontakt”, atëherë ky formulim është diskriminues, që do të thotë: vëllai diskriminohet për shkak të vëllait, gjë që të kujton edhe të kaluarën e regjimit. I gjithë sistemi demokratik ngrihet mbi të drejta dhe liritë themelore të individit. Në këtë rast, duke përdorur këtë term, apo duke kufizuar zgjedhjen e subjekteve nëpërmjet një organi që do të ngrihet për verifikimin e këtyre figurave, ne pa dashje shkojmë në një diskriminim racor, gjinor dhe shoqëror. Pra, kufizimet e të drejtave dhe lirive nuk mund të jenë të tilla që të cenojnë vetë thelbin e të drejtës. Për këtë arsye edhe jurisprudenca e Gjykatës Europiane e të Drejtave të Njeriut ka raste të ndryshme.

Në këtë projekt-draft, pra duke folur vetëm nga pikëpamja juridike, duhen përcaktuar qartë se çfarë është kontakti. Cilët janë persona që duhet të lidhen me këtë kontakt? Cili do të jetë organi që do të marrë në analizë këto persona? Çfarë tagri duhet të ketë ky organ dhe të tjera me radhë si këto?

Faleminderit!

Klotilda Bushka – Faleminderit, zonja Peto!

Nëse do të kishit mundësi të përcillnit me shkrim këto sugjerime, do të ishte shumë ndihmë për punën e kësaj mbledhjeje dhe të këtij komisioni.

Kush e do fjalën? Po, profesor Malaj!

Arben Malaj – Unë përfaqësoj Institutin për Mirëqeverisje.

Së pari, mendoj që Kuvendi, por edhe opinioni publik duhet të jetë më i shqetësuar për sfidat që ka mirëqeverisja. Konkretisht, në disa sondazhe të fundit në vendet moderne të Europës, mbi 60% e opinionit publik mendon se qeveritë punojnë për të fortit dhe të pasurit.

Për shkak të dështimeve të qeverive në rotacionet e ndryshme, rreth 80% e votuesve në Francë, para 6 muajsh ishin dakord të votonin një lider që u ndryshonte jetën e përditshme, por nuk ishte i kujdesshëm për demokracinë. Pasojat e këtyre perceptimeve i ndjejmë deri në vendin tonë, sidomos në temperaturën e ambientit politik që zhvillohet, por edhe në dëshirat për të ikur dhe për të gjetur një mundësi më të mirë jashtë Shqipërisë. Prandaj, në këtë aspekt unë pajtohem edhe me thirrjen e përfaqësuesit të opozitës që akademikët dhe personat me influencë publike duhet të jenë më aktivë, jo për ta përkeqësuar situatën, por për të ndihmuar që në mënyrë graduale të përmirësohet dhe të krijojmë më shumë perspektive pozitive. Në këtë aspekt është

shumë i rëndësishëm vendi që ka politika, cilësia e të zgjedhurve me mandate kushtetuese dhe efienca e tyre.

Në rastin konkret, duke mirëkuptuar kërkesën që bën një forcë opozitare, kam një shqetësim bazuar edhe në eksperiencën 16-vjeçare në parlament, që Kushtetuta e vendit tonë nga një libër themelor për vlera dhe parimet e një demokracie funksionale, po bëhet më shumë një libër rregullash. Pra, për çdo problem që del në Shqipëri kërkohet një zgjidhje kushtetuese. Kjo vjen më së tepërmi nga mosbesimi mes partive kryesore politike, por që nuk e përlij kërkesën që Kushtetuta e vendit tonë të ketë këtë formatim që pastaj do ta bëjë edhe më të vështirë implementimin e saj.

E dyta, duke parë debatin politik, por duke parë edhe propozimin konkret, duket sikur gjithnjë e më tepër po vihet në fokus individi lidhur me aktivitetin kriminal, kur në fakt duhet të jetë vepra kriminale. Nëse vepra kriminale të çon te një njeri me mandat kushtetues, që ka një mbrojtje të veçantë, që parlamenti ka rrëzuar një pjesë të tyre, atëherë ligjet penale në këtë fazë duhet të jenë më të lehtë për t'u implementuar, që askush të mos ndiejë një mbështetje të veçantë në mandatin e tij. Në rast të kundërt, çfarëdo ndryshimi ligjor që mund të bëhet, do të rezistojë përkohësisht, kjo është si puna e ilaçit ku sëmundja mësohet me ilaçin, pastaj duhet një ilaç tjetër për ta shëruar.

E fundit që dua të theksoj dhe shumë e rëndësishme është bazimi te kodet morale. Eksperienca më e mirë vjen nga Amerika, nga presidenti George Washington, i cili nuk pranoi të ishte president për herë të tretë në vendin e tij. Kjo funksionoi në ambientin politik amerikan për rreth 100 vjet, pastaj u bë pjesë e shkruar. Pra, duhet të kemi eksperienca pozitive dhe pastaj duhet t'i kalojmë në ligjet themelore dhe jo të ndryshojmë ligjet sa herë që na lind një debat publik.

Nga zhvillimet e fundit politike në Europë në votimet është e rëndësishme pjesëmarrja. Në politikë thuhet: "Politikanë e këqij i zgjedhin njerëzit e mirë, ata që nuk votojnë". Prandaj sfidat që kemi nuk mund të përballohen me ndryshime të herëpashershme në dokumentet tona themelore, por duhet të jenë sfida kombëtare. Në këtë debat formula më e mirë, e bazuar në kodet morale, është demokratizimi i partive politike, sepse flasim për cilësinë e atyre që marrin mandate kushtetuese. Nëse cilësia përmirësohet dhe bazohet në vlerat individuale, morale, etike dhe profesionale, nuk do të na duhen ligje të tilla. Nëse mendojmë të anashkalojmë këto kërkesa

themelore për të mandatuarit politikë, atëherë nuk na mjafton asnjë ligj qoftë ky edhe pjesë strikte e Kushtetutës së vendit tonë.

Faleminderit!

Ulsi Manja – Faleminderit zoti Malaj.

Kush e do fjalën tjetër?

Po, profesor.

Kosta Gazeli – Në radhë të parë, ju falënderoj për ftesën për të shprehur mendimet tona lidhur me këtë çështje shumë të rëndësishme!

Së pari, unë mendoj se duhet të jemi shumë të rezervuar kur bëhet fjalë për ndryshime në Kushtetutë dhe, këtë e theksoj, duke u nisur nga përvoja e ndryshimeve kushtetuese që kemi bërë aktualisht për sa u përket reformës në drejtësi dhe vetingut në drejtësi. Të gjithë jemi dëshmitarë se çfarë problemesh hasen në rrugën për bërjen e vetingut në drejtësi. Me një fjalë, nuk është një gjë e kollajtë, aq më tepër kur vetingu në politikë, në radhë të parë, bëhet nëpërmjet zgjedhjeve; e bën vetë populli nëpërmjet zgjedhjeve në Kuvendin popullor. Nuk ka pjesëmarrës më të mirë në veting se populli në rastin e zgjedhjeve për deputet.

Nga ana tjetër, që të bësh vetingun në politikë, do të duhet një strukturë e veçantë me një infrastrukturë të sajën, me shpenzime të jashtëzakonshme, sepse gjyqtarët dhe prokurorët mund të jenë gjithsej 1000 ose 1500, por për sa u përket politikanëve, ku merret vesh se si janë, pasi aty përfshihen deputetët, janë ministrat, është Kryeministri, janë drejtorët e institucioneve qendrore, si të thuash, të veçantë; janë drejtorët e Përgjithshëm, funksione këto që vihen nga partitë që fitojnë zgjedhjet. Pra, do të duhet që për këtë strukturë, krahas kuadrit, me një fjalë, që do të duhet, do të duhen shpenzime të jashtëzakonshme dhe do të mbahet në mënyrë të përhershme. Se vetingu në drejtësi do të bëhet për një periudhë aq sa është lënë, pesë ose gjashtë vjet, ndërsa po të bësh veting në politikë, do të duhet ta bësh në mënyrë permanente dhe me shpenzime të jashtëzakonshme. Lëre më pastaj që ka probleme për sa i përket përbërjes së strukturës që do të merret me vetingun në politikë. Kush do të marrë pjesë në të? Kush do t'i caktojë këta? Nuk është një gjë e lehtë.

Gjithashtu, unë kam mendimin se vetingu në politikë nuk është i nevojshëm për sa kohë ne kemi vetingun në drejtësi. Kemi krijuar gjithë këto organe, si: Prokuroria e Posaçme, Byroja Kombëtare e Hetimit e të tjerë. Nëse kemi çështje që kanë lidhje me politikanë të ndryshëm,

shumë mirë, mund të bëhet një shtesë në ligjin përkatës dhe t'i kalojnë Byrosë Kombëtare të Hetimit. Çfarë ka?

Tjetër, ka ligje, siç është ai i antimafias. Nëse kemi dyshime për një person që ka pasuri të jashtëzakonshme, të cilat mund t'i ketë vënë në rrugë të jashtëligjshme, urdhëro, kaloja organit kompetent, që përcaktohet në ligjin për mafien.

Tjetër, kemi Kolegjin Zgjedhor kur vjen puna, që kalojnë në filtër kur ka ankime lidhur me personat që zgjidhen.

Pra, janë një sërë çështjesh, të cilat mendoj se e bëjnë të panevojshëm vetingun në politikë, por, mbi të gjitha, duhen shpenzime të jashtëzakonshme, sepse do të duhet ta mbash në mënyrë permanente.

Faleminderit!

Ulsi Manja – Faleminderit, zoti Gazeli, për mendimet tuaja!

E njëjta kërkesë vlen edhe ju, do të ishte mirë të na i sillnit me shkrim sugjerimet dhe komentet tuaja lidhur me nismën.

Kush e do fjalën? Po, zonja Mandija.

Ju lutem, prezantohuni! Cilin universitet përfaqësoni?

Ledina Mandija – Faleminderit, zoti Manja, për ftesën!

Jam drejtoreshë departamenti në Fakultetin e Drejtësisë të Universitetit Europian të Tiranës. Jam njohur para dy ditëve me draftligjin dhe në lidhje me kërkesën për të dhënë mendime lidhur me këtë, ndaj në parim dua të them se nuk është mirë vërtet që të ketë ndryshime të shpeshta kushtetuese.

Në fakt, në Republikën e Shqipërisë nuk mund të bëjmë paralelizma me Shtetet e Bashkuara të Amerikës, pikërisht sepse situatat në Republikën e Shqipërisë kanë qenë të tilla, që kanë kërkuar dhe kanë detyruar ndryshimet kushtetuese.

Në vitin 2014, kur filloi edhe nisma për reformën në drejtësi, u diskutua edhe për amendime kushtetuese. Ndaj do të kishte qenë e mira që edhe politika të kishte qenë më e përgjegjshme që ta analizonte në detaje dhe të binte dakord edhe për ndryshimet kushtetuese, falë edhe situatës aktuale që ishte në Shqipëri.

Referuar dekriminalizimit, ne pamë se kishte shumë deputetë me vendime penale goftë brenda, goftë jashtë vendit. Nisur nga situata, siç duket, është parë me vend të ketë sërish ndryshime kushtetuese, meqenëse kjo nuk u analizua tërësisht në vitin 2014. Unë e them dhe e

përsëris se në vitin 2014, ndoshta në atë kohë kur edhe politika duhet të binte dakord, edhe ekspertët të punonin në këtë drejtim, të mos mendonin vetëm për gjyqësorin, por të mendonin edhe për politikën, pra për deputetët, për ata persona të cilët përfaqësojnë interesat e popullit në parlament dhe që më vonë ato votojnë edhe ligjet. Pra, ishin ato persona të cilët ishin pjesë dhe votuan reformën në drejtësi.

Përveç kësaj, ka edhe persona të tjerë, që ushtrojnë funksione publike shumë të rëndësishme, të cilët nuk janë kontrolluar ndonjëherë qoftë për sa i përket integritetit të tyre, qoftë për sa u përket edhe pasurive të tyre.

Kështu që, me të vërtetë nuk është mirë që Kushtetuta të ndryshohet, por mendoj se në situata të jashtëzakonshme dhe në kushtet e faktet ku Shqipëria ndodhet duhet të bëhen ndryshime të tilla kushtetuese.

Për sa i përket pastaj terminologjisë për sa u takon kontakteve të papërshtatshme, ne e pamë se DSIK-ja, në rastin e reformës në drejtësi, thoshte: “Një person ka kontakte të papërshtatshme”, ndërkohë që komisioni thoshte: “Nuk ka kontakte të papërshtatshme”. Pra, ka vlerësime të ndryshme.

Në këtë kontekst, unë mendoj se mund të vendosej edhe përkufizimi në lidhje me kontaktet e papërshtatshme për sa i përket krimit të organizuar, ndërsa në lidhje me mekanizmin, mendoj se mekanizmi ngrihet. Vërtet ka kosto, por ne kemi shumë institucione të pavarura dhe, në qoftë se ekziston vullneti, gjendet edhe mënyra se si do të bëhet kontrolli i këtyre figurave, të cilët janë jo vetëm deputetë të Kuvendit të Shqipërisë, por gjithashtu mbajnë funksione publike të rëndësishme apo drejtojnë drejtori të rëndësishme. Kaq kisha.

Ulsi Manja – Faleminderit, zonja Mandia!

Po, zoti Gazeli.

Kosta Gazeli - Kam për të thënë edhe diçka tjetër.

Ky lloj vetingu është në kundërshtim edhe me të drejtat themelore të njeriut.

E drejta për të zgjedhur dhe për t’u zgjedhur njihet botërisht. Nëse një politikani që ka kontakt me një të dënuar apo ka njeri të afërm të dënuar i hiqet e drejta për t’u zgjedhur, atëherë duhet t’i hiqet edhe e drejta për të zgjedhur. Për shembull, unë mund të marr pjesë në një event të caktuar, ku edhe të takoj njerëz të ndryshëm. Për arsye se mund të kem kënduar, kërcyer apo dalë në fotografi me ics person, do të më privohet e drejta për t’u zgjedhur? Kjo nuk qëndron.

Faleminderit!

Ulsi Manja – Faleminderit!

Po, zoti Hoxha.

Artan Hoxha – Ne vijmë nga bota akademike dhe duam të shprehim mendimin tonë, por ju na vendosni në pozicione dhe në siklet në mënyrën si duhet të parashtrojmë opinionin tonë.

Si persona që merremi me ligjin, që e krijojmë dhe e shpjegojmë atë (krijimi është në fazën përgatitore), mendoj se Kushtetuta është dokumenti më i rëndësishëm i shtetit. Kushtetuta nuk është akt që bëhet dhe ribëhet sa herë ne duam, por atëherë kur është e nevojshme. Në botë kushtetutat janë të qëndrueshme dhe të ndryshueshme. Përpara se ta ndryshohet dhe amendohet një Kushtetutë, duhet të bëhet vlerësimi dhe studimi paraprak i situatës që do të çojë edhe në propozime reale për të ndryshuar një situatë, e cila konstatohet se ka vend për t'u amenduar apo përmirësuar.

Ajo që ne flasim shpesh, që kushtetutat përcaktojnë vlerat demokratike, sigurinë juridike, të drejtat e individit dhe janë dokumente të qëndrueshme, është mënyra si vetë Kuvendi duhet të silltet me Kushtetutën, sepse populli i ka dhënë Kuvendit të drejtën të bëjë ndryshime, por jo të karakterit subjektiv.

Bëhet një referencë me reformën në drejtësi, e cila ishte përpara një situatë anomaliteti dhe bëhet fjalë për subjekte, të cilat emërohen përjetë në detyrën e gjyqtarit apo prokurorit. Kjo do të thotë që për aq kohë sa atyre do t'ju vijë mosha për të dalë në pension, nëse nuk kryejnë asnjë veprim që bie ndesh me ligjin dhe me etikën, do të qëndrojnë në detyrë pa qenë nevoja e rivlerësimit të tyre. I vetmi rivlerësim që bëhet për ta është për efekte të karrierës në sistem.

Këtu bëhet fjalë për persona, të cilët nuk janë të qëndrueshëm në detyrë. Për shembull, njerëzit e zgjedhur zgjidhen për 4 vjet maksimalisht. Po ashtu edhe njerëz në funksione të tjera zgjidhen me afate kohore të caktuara. Kështu që, për të ardhur në barazi të diskutimit, mendoj se nuk ka barazi. Një i zgjedhur do të mendoj të përcaktoj disa rregulla paraprakisht dhe për më pas, apo duhet të bëj punën që i ka caktuar populli për aq mandat të kufizuar që ai ka?

Së dyti, rregullat që ka përcaktuar Kushtetuta për vetingun në drejtësi janë të konsoliduara fort. Ato kanë organet kushtetuese që bëjnë verifikimin e figurës, kanë

monitorimin ndërkombëtar të veprimtarisë së këtyre organeve dhe, më kryesorja, është për një periudhë të përkohshme të aplikimit të saj. Ndërkohë, ajo që propozohet, në fakt, nuk është vetëm për politikanët, por shumë më e gjerë. Janë të gjithë zyrtarët. Duket sikur është vetëm për drejtuesit, por, në fakt, është për të gjithë zyrtarët e shtetit.

Shteti nuk funksionon me organe vetingu, por me strukturat e veta. Ai është i ndërtuar me pushtetet e veta dhe me institucione nga të cilat kërkohet të zbatojnë ligjin. Për të ndryshuar Kushtetutën duhet të shikosh nëse nuk ka mundësi tjetër zgjidhjeje për një situatë të caktuar. Mendoj se është problematike jo vetëm lidhja e politikës dhe e njerëzve që ushtrojnë funksione të larta me krimin apo me subjektet, të cilat janë të papërshtatshme në tërësinë e fjalës. Unë mendoj se e keqja në shtetin shqiptar nuk është vetëm në sistemin gjyqësor. Kjo është një shoqëri, e cila ka problematikat e veta, në politikë, në ekzekutiv, në drejtësi dhe kudo.

Nevoja për të përmirësuar mekanizmat për të luftuar të keqen, është një nevojë e vazhdueshme dhe një nevojë që vjen për të përmirësuar demokracinë në Shqipëri. Në këtë pikëpamje, unë nuk jam kundër në parim proceseve të verifikimit dhe të kërkesës së llogarisë.

A jemi në nivel kushtetues apo jemi në një nivel tjetër? Unë them, se ndryshimet që Kuvendi i ka bërë Kushtetutës në vitin 2015, kur ka ndryshuar nenin 6/1, nenin 45, paragrafi 3, e ka zgjeruar në fakt gamën e procesit të verifikimit të figurës së zyrtarëve në tërësinë e vet, sipas mendimit tim personal, më shumë se ç'duhet, por kjo është personale dhe nuk ka të bëjë me gjykimin, nëse është apo nuk është e drejtë, sepse koncepti i atij që nuk merr pjesë në një proces zgjedhjeje apo nuk mund të vazhdojë me një detyrë, ka qenë i lidhur me një vendim gjyqësor të formës së prerë, ose për paaftësi mendore, ose për paaftësi për shkak të moshës. Pra, vetëm situata objektive mund të të mohonin një të drejtë, siç është e drejta të zgjedhësh, të zgjidhesh, apo të jesh pjesëmarrës nëse plotëson kriteret në funksione të ndryshme administrative.

Megjithatë, ky Kuvend e ka zgjeruar, e ka bërë shumë të gjerë. Në nenin 6/1 thuhet: “Ndalohej zgjedhja, emërimi apo ushtrimi i një funksioni publik në një nga organet e parashikuara në këtë Kushtetutë, ose të krijuara me ligj, pavarësisht përcaktimeve të bëra në dispozitat e tjera të kësaj Kushtetute, nëse verifikohen rrethana që cenojnë integritetin e funksionarit publik, sipas kushteve dhe rregullave të përcaktuara me ligj, të miratuara me tri të pestat e të gjithë anëtarëve të Kuvendit.”

Ja ku është Kushtetuta. Ajo është për këdo. Me rregulla ligjore mund të përcaktosh se si duhet të kalojë një kandidat për diku, me një ligj të posaçëm, me disa procedura, disa

deklarime, disa verifikime paraprake apo edhe me verifikime të mëtejshme. Kushtetuta e ka të hapur. Edhe po të shohësh nenin 45, paragrafi i tretë, thotë të njëjtën gjë për personat e zgjedhur.

Nëse ne nuk gjejmë dot zgjidhje kushtetuese për një situatë të caktuar, atëherë i drejtohem Kushtetutës për ta amenduar, për ta shtuar, apo për ta përmirësuar.

Në të kundërt, nëse Kushtetuta e ka, ajo që i mbetet ligjvënësit është të përcaktojë rregullat ligjore. Jo pa qëllim në vitin 2015 u bë një studim paraprak dhe ky me sa di unë, është një propozim i opozitës, që ka sjellë efekte edhe te deputetët, edhe te të zgjedhurit vendorë, edhe te të emëruarit apo të zgjedhurit në organet kushtetuese. Ka pasur një studim për të, si dhe një paketë ligjore. Një nga ata është edhe ligji për garantimin e integritetit të personave të zgjedhur dhe të emëruar, që e tha njëra nga koleget e IAL-ve.

Nëse Kushtetuta thotë: “integritetin e funksionarit publik”, çfarë do të thotë ky term? Do të thotë: kontakte të papërshtatshme (që është një çështje ligji), edhe pasuri të pajustificuar, edhe kryerja e një vepre penale, edhe sjellje në kundërshtim me etikën e profesionit, që do të marrë përsipër të kryejë, apo asaj për të cilën do të zgjidhet.

A ka mundësi që kjo situatë të zgjidhet me ligj? Nëse ka mundësi që kjo situatë të zgjidhet me ligj, atëherë nuk kemi pse t’i drejtohem Kushtetutës. Unë po them se nenet 6/1 dhe 45/3 janë shumë të gjerë, madje janë më shumë të gjerë sesa në mbrojtje të interesave të individit, sepse duhet të kemi një balancë, sepse kemi edhe mbrojtje të interesave të individit, por kemi edhe mbrojtje të interesit publik. Megjithatë, ky është fakt kushtetues, i cili është i rregulluar tashmë.

Çfarë propozohet tani? Unë mendoj se ndoshta është një propozim i përgjithshëm dhe joezaurues, edhe po të marrësh përmbajtjen e tekstit.

Nëse në tekstin kushtetues nuk propozohet të thuhet, se kush është organi dhe cila është procedura, ashtu siç është thënë për sistemin gjyqësor, por t’ia lësh ligjeve të veçanta, kjo nuk të jep asnjë lloj garancie për sigurinë juridike, për mbrojtjen e individit dhe për garantimin e parimit të prezumimit të pafajësisë, përveç termave se i thanë. Këtu (në reformën në drejtësi), thuhet se ka kontakte të papërshtatshme. Duhet bërë interpretimi i fjalës “kontakt” dhe të termit “kontakte të papërshtatshme”.

Nuk dua te kjo pjesë. Po sikur të thoshim: dakord, ta vendosim një organ në Kushtetutë që të bëjë vetingun e politikanëve, por edhe të të zgjedhurve të tjerë (kaq i gjerë sa është). Çfarë do të jetë ky organ? Do të jetë një superorgan? Kush e garanton, që ky organ nuk do të përdoret

politikisht? Do të jetë një superorgan që do të përdoret nga ata që janë në pushtet? Kush është ky organ? A ka organ më të lartë sesa Kuvendi?

Kush do të ishte ky organ, të cilin do ta krijonte Kuvendi apo një mekanizëm tjetër, i cili do të garantonte paanësinë në ushtrimin e funksionit të vet nga pushteti, pra do të krijonin një superorgan, i cili në vetvete, në mënyrën se si funksion në Shqipëri, mund të përdoret politikisht. Pra, në kundërshtim me vullnetin që të pastrojmë, do të kthehej në një vullnet të kundërt me atë që është propozuar, që mund të instrumentalizohet politikisht.

Së dyti, superorgane nuk ka, edhe ato struktura që janë krijuar për reformën në drejtësi, edhe ato janë të përkohshme, edhe ato janë në monitorim, edhe ato janë për njerëz që qëndrojnë në detyrë gjatë gjithë kohës që ata janë dhe nuk janë të përkohshme.

Po strukturat e tjera të shtetit si funksionojnë? Ne kemi tatime, kemi taksa, kemi DSIK, kemi ILKDPI, kemi institucione kushtetuese dhe ligjore, të cilat, në vetvete, përbëjnë të gjithë ingranazhet e funksionimit të shtetit. Duhet të kemi një model të një vendi tjetër, që ta gjejmë, se diku është një rregullim i tillë. Pastaj ka edhe një gjë: ne nuk mund t'i lëmë njollën Kushtetutës për një situatë anormale të momentit, sepse Kushtetuta është për sot, por edhe për shumë vite pas. Në të gjithë botën ne shikojmë se kushtetutat amendohen, kanë fraksionet e tyre, por nuk e humbasin historinë e tyre. Ne po e luajmë Kushtetutën sikur të jetë një dokument i thjeshtë.

Reforma në drejtësi pati disa vite, sot në praktikë shikojmë që një pjesë e zgjidhjeve nuk kanë qenë ato që duhet, ose nuk interpretohen siç duhet, dhe mund të sjellin pasoja për vetë procesin. Kështu që të ndërmarrësh aksione të një niveli të tillë, së pari, kërkohet është një diskutim paraprak i gjatë me të gjithë ata që mund të japin opinione të vlefshme dhe më pas të kalohet në propozimet, të cilat janë substanciale për të ardhmen e vendit. Kushtetutat nuk janë dokumente që trajtohen si ligje të zakonshme. Kështu që, nga kjo pikëpamje unë e vlerësoj nismën, por mënyra se si duhet vepruar dhe nëse është e nevojshme në Kushtetutë apo jo, duhen bërë disa diskutime më të thella.

Në mendimin tim paraprak, populli thotë: “Në vend të vësh vetulla, nxjerr sytë”, sepse po të krijojmë struktura, të cilat nesër mund të kontrollohen nga dikush, sepse janë të përqendruara, atëherë efekti i asaj që kërkohet është i kundërt me atë vullnet, që për mua është i mirë, por mekanizmi nuk është i duhuri.

Faleminderit!

Ulsi Manja – Faleminderit, zoti Hoxha, për mendimin që parashtuat!

Do t'ju lutesha që t'i kishim edhe me shkrim mendimet tuaja në Këshillin e Legjislacionit dhe në Komisionin e Ligjeve, pasi së bashku dhe me mendimet e ekspertëve konstitucionalitë të të dyja krahëve politikë, që janë caktuar nga ky Këshill, që kanë marrë edhe pyetjet e opozitës, por edhe pyetjet tona në raport me nismën e Partisë Demokratike, plus që do t'i shtohet edhe opinionin e Komisionit të Venecies, që, besoj se do të jetë në dispozicion të këtij Këshilli deri në dhjetor, do të arrijmë në një konkluzion nëse nisma, përtej qëllimit të mirë që ka, duhet të miratohet në variantin siç është parashtruar nga opozita, pra në variantin e ndryshimeve kushtetuese, apo ndoshta do të ketë nevojë për një ligj të posaçëm me 3/5-tat. Gjithsesi, kjo është çështje e vendimmarrjes politike, pasi do të kemi marrë edhe mendimin e gjithë të ekspertëve të fushës, Komisionit të Venecies, por, pse jo edhe të kësaj tryeze shumë të çmuar.

Për të vazhduar më tej, kush e do fjalën?

Urdhëroni, zoti Dobjani!

Ermir Dobjani - Faleminderit!

Ermir Dojani, profesor në Fakultetin e Drejtësisë, të Universitetin e Tiranës, Departamenti Publik. Faleminderit për ftesën që na bëtë!

Faktikisht dekani dhe kolegët e tjerë i trajtuan drejt çështjet teknike, mendoj si ata në përgjithësi Nuk diskutohet, qëllimi i mirë për të bërë veting në politikë duhet të jetë një objektiv i vetë klasës politike në Shqipëri. Pa hyrë shumë në pjesën teknike, mendimi im është se Republika e Shqipërisë në këta 15 vjetët e fundit konsiderohet si një vend që ka inflacion legjislacioni. Është fakt se ne në Shqipëri kemi prodhuar shumë legjislacion, që në përgjithësi ka qenë i nevojshëm, por Shqipëria dhe institucionet vuajnë nga zbatimi i plotë dhe rigoroz i këtij legjislacioni. Në këtë kuadër e shikoj dhe këtë iniciativë të këtij projekti për ndryshimin e Kushtetutës. Thashë nuk do t'i futem edhe një herë diskutimit se nuk duhej të bëhej ky ndryshim i Kushtetutës pa parë mirë se si ka funksionuar ligji nr. 138/2018 “Për integritetin e figurës së personave të zgjedhur dhe të emëruar në administratën publike”.

Klasa politike vazhdon ende të akuzojnë njëra-tjetrën pa emra, për deputetë apo për zyrtarë të lartë të dënuar ose të padënuar. Faktikisht, po të marrim parasysh që ka një ligj për dekriminalizimin, atëherë pse dalin me ndryshime, propozime të reja, pa thënë emrat se kush janë ata persona që janë deputetë të njërës palë apo të palës tjetër, që nuk e meritojnë të jenë për mungesë integriteti në këtë parlament.

Paraqitja e këtij projektligji kushtetues në këtë formë, i pashoqëruar me një projekt paraprak për zbatimin e tij, mendoj se është pjesa më e dobët e këtij projekti. Pavarësisht këtyre, u theksua nga disa diskutantë nga pikëpamja teknike, kriteri që insiston për ta bërë, që thonë nocioni i kontakteve me persona të krimit të organizuar, ky është një nocion, që nga pikëpamja kushtetuese quhet nocion i papërcaktuar. Futja në Kushtetutë e këtij nocioni do të kërkonte të bëhej një rregullore me dhjetëra raste, me kontakte të papërshtatshme dhe çdo person ndaj të cilit do të zbatohet ky ligj do të kthehej në një proces ligjor të personit i cili do të goditej, pastaj lidhur edhe me zbatimin e parimit të procesit të rregullt ligjor të pakufizuar në kohë dhe të pambaruar në hapësirë dhe në kohë për këta personat që janë politikë, të cilët janë me dhjetëra, për të mos thënë me qindra njerëz.

Pa u zgjatur më, unë mendoj se vetingun e politikanëve e kanë në dorë ta bëjnë shumë mirë partitë politike, duke u demokratizuar dhe këtu bashkohem me mendimin e profesor Arbenit që ishte këtu. Partitë politike duhet të zgjerojnë fushëpamjen e tyre në lidhje me anëtarët dhe ata të cilët kanë bërë dhe bëjnë karrierë brenda partisë për t'u demokratizuar dhe për ta lidhur karrierën në parti me vlerat e secilit anëtar i cili bën pjesë në të.

Dihet se partitë politike janë organizma në dobi të shoqërisë dhe të vendit dhe duhet që partitë politike pa dallim të mos shpenzojnë kohë me projekte të momentit për të luftuar individë të caktuar, por ta shpenzojmë kohën e tyre për hartimin e ligjeve, për të cilat ka ardhur koha që duhet të bëhen në Shqipëri, duke filluar nga ligji për financimin e partive politike dhe proceseve zgjedhore dhe një përpunim rrënjësor i ligjit për partitë politike në Shqipëri. Shumë gjëra mund t'i eliminojmë nëpërmjet këtyre ligjeve, pra sëmundjeve që ndeshen në politikën shqiptare.

Nuk dua të zgjatem më tepër.

Ju falënderoj për vëmendjen!

Ulsi Manja – Faleminderit, profesor Dobjani!

Po, zoti Muçalla.

Naim Mëçalla – Naim Mëçalla dekan i Fakultetit të Drejtësisë në Kolegjin Universitar *Wisdom*.

Në një shoqëri demokratike në qendër të vëmendjes është individi, interesat, liritë dhe të drejtat e tij. mendoj paraprakisht se nuk mund të përjashtohet nga e drejta për t'u zgjedhur, të paktën në nivel kushtetues, një shtetas i cili sipas propozimit të bërë mund të jetë në kontakt edhe me personat e përfshirë në krimin e organizuar. Për mua është një cenim i të Drejtës Kushtetuese.

Të paktën në nivel ligji, qoftë për ligjin e dekriminalizimit, tek i cili mund të ndërhyhet, madje edhe për ligjet e tjera që janë miratuar, unë kam vërejtje, sepse një kategori e caktuar personash, të cilët kanë mbaruar një program studimi përjashtohen nga e drejta për t'u zgjedhur në organe të ndryshme të vetingut. Prandaj është e papranueshme që të përjashtohen në nivel kushtetues shtetas të caktuar, që këtë të drejtë për përjashtim, ashtu siç është standardi kushtetues, e ka vetëm gjykata.

Mendoj se reforma në drejtësi, strukturat e posaçme, si dhe instrumentet ligjore që janë në fuqi, janë reforma që do të sjellin pastrimin e politikës, sekuestrimin e pasurive kriminale dhe shumë veprime të tjera. Për mua është e papranueshme për t'u përjashtuar nga e drejta për t'u zgjedhur në nivel kushtetues.

Faleminderit!

Ulsi Manja –Faleminderit, zoti Meçalla!

Zonja Mandia, fjala për ju.

Ledina Mandia- Më falni për ndërhyrjen, por dëgjova kolegët në lidhje me

vlerësimin e situatës aktuale. I kam hedhur një sy draftligjit dhe shoh disa shifra të rezultateve të reformës së dekriminalizimit. Domethënë, aty ka shifra konkrete në lidhje me deputetë, zyrtarë të lartë, këshilltarë bashkiakë e të tjerë.

Gjithashtu, ne kemi raporte të OSBE-së në lidhje me shitblerjen e votës, i cili është një fenomen që e njohim të gjithë, pak rëndësi ka se nga cilat forcë politike vjen ky fenomen, por e rëndësishme është që ekziston.

Ne shohim që po bëhet vetingu i gjyqtarëve, por po shohim raportin nga DSIK-ja për kontakte të papërshtatshme. Shohim se Inspektorati i Pasurive ka vepruar gjithë këto vite, por prapë na dalin persona që kanë pasuri të pajustificuara, ndërkohë që institucionet kanë ekzistuar. Pra, kjo do të thotë se gjendemi në një situatë, ku edhe deputetë të Kuvendit të Shqipërisë aktualë, edhe ata që do të vijnë në të ardhmen duhet të kalojnë në një proces të tillë.

E thashë edhe një herë tjetër që mekanizmi ia vlen të diskutohet. Unë mendoj që me të vërtetë nuk ekzistojnë supermekanizmat, por edhe për reformën në drejtësi u gjet një mekanizëm. Kur vullneti mes palëve ekziston, mekanizmi gjendet. Në qoftë se ne do të mendojmë se po krijohen superorgane, atëherë nuk do të mundemi ta ndryshojmë situatën. Unë mendoj se për vlerësimin e situatës ka raporte, të cilat duhet të mblidhen dhe mbi bazë të këtyre raporteve dhe të këtyre vlerësimeve ka ardhur edhe ky draftligj. Nuk e di nëse do të bëhen përmirësime në të që

të vijë në një formë finale, të përshtatshme. Mbaj mend se kur diskutohej reforma në drejtësi, u diskutua në lidhje me ILDKP-në, se kush do ta kontrollonte, sepse ata do të bënin vlerësimet e gjyqtarëve dhe të prokurorëve; kush do ta kontrollonte DSIK-në, sepse ata do të bënin vlerësimin e integritetit të figurës së gjyqtarëve apo edhe në lidhje me Shkollën e Magjistraturës që bënte vlerësimin profesional në fund, në qoftë se nuk ishin të përshtatshëm.

Në këto kushte, në qoftë se ka një vullnet, nuk është rasti për një supermekanizëm, por për një mekanizëm, i cili duhet të jetë kushtetues dhe të bëjë vlerësimin përfundimtar të këtyre personave që i ushtrojnë këto funksione apo që do t'i marrin në të ardhmen.

Faleminderit, zonja Manja!

Ulsi Manja – Faleminderit, zonja Mandia!

Fjalën e ka profesoreshë Katro.

Kestrin Katro – Unë jam Kestrin Katro, pedagoge e Fakultetit të Drejtësisë, Universiteti i Tiranës.

Gjatë kohës që kemi bërë konsultimet për reformën në drejtësi, unë kam qenë ndër personat që kam folur në këto takime dhe kam thënë se duhet të ketë një lëvizje të tillë, për reformë dhe veting në politikë, së pari.

Kishte akuza të herëpashershme, përplasje të politikanëve me njëri-tjetrin, një amulli që krijohej në publik, sepse kushdo atakonte këdo. Boll të kishe një pozicion të caktuar në politikë apo në administratën shtetërore ishte një person, i cili menjëherë shigjetohej. Pra, unë kam qenë nga ata persona që e kam thënë 3 apo 4 vjet më parë një gjë të tillë.

Megjithatë, nuk më duket rruga e përshtatshme që vetëm 4 nene të amenduara në Kushtetutë mund ta realizonin një gjë të tillë. Siç u bë ai studimi i thellë dhe për një kohë të gjatë për reformën në drejtësi, në qoftë se do të ekzistonte vullneti politik, mendoj se mund të realizohej një reformë, por jo për 4 nene, aq më tepër që nuk janë të shtjelluara më gjatë. Po t'i vëmë këto 4 nene në Kushtetutë, më pas do të nxitojmë të vëmë ligje të tjera, të krijojmë ca gjëra të tjera, që do të jenë ndoshta të nxituara dhe do ta kthejnë më tepër këtë në një gjueti shtrigash.

Për mua një studim dhe një reformë e mirëfilltë do ta pranoja si ide, për më tepër duke u nisur edhe nga fakti i të kaluarës sonë, ku Sigurimi i Shtetit ishte kthyer në organin kryesor të drejtimit të shtetit, pavarësisht organeve të tjera do të kisha frikë se po të bëhej i nxituar ky ligj do të na nxirrte disa organe të tjera, si Sigurimi i Shtetit i dikurshëm dhe do të kishim prapë nene të ngjashme me ato të agjitacion -propagandës. Prandaj them se duhet një studim i plotë jo

vetëm i ndryshimeve kushtetuese, por edhe i ligjit se kush do ta bëjë dhe si do të ndërtohet, kemi dhe faktin se kush do t'i zgjedhë këta persona. Të kontrollojnë politikanët dhe duhet të vendosen nga politikanët është një formulë që nuk shkon, është një konflikt i mirëfilltë interesi, kushdo do të tentonte të zgjidhte njerëzit që i njihte dhe për këtë arsye më duket e paplotë, ose shumë e nxituar për t'u bërë.

Faleminderit!

Ulsi Manja- Faleminderit, profesoreshe Katro!

Kush e do fjalën?

Me sa duket nuk ka më komente ose opinione të tjera nga përfaqësuesit e botës akademike dhe universitare.

Unë e vlerësoj shumë këtë tryezë, është një ndër tryezat e konsultimit më frytdhënëse që kemi zhvilluar deri tani për nismën e opozitës për ndryshime kushtetuese.

Unë do të doja për opinionin publik, por edhe për përfaqësuesit në këtë tryezë, që kanë gjithë respektin dhe mirënjohjen tonë, të cilët iu përgjigjen ftesës së Kuvendit për ndryshime kushtetuese, se edhe unë vetë që në fillim, jo vetëm tani, por edhe në ndryshimet e mëparshme që ka pësuar Kushtetuta jonë, kam qenë dhe vazhdoj të jem i mendimit që jo më kot Rregullorja e Kuvendit dhe Kushtetuta ka përcaktuar një procedurë të veçantë për ndryshimet kushtetuese, sepse bëhet fjalë jo për një ligj të zakonshëm, por bëhet fjalë për aktin themelor të shtetit dhe çdo lloj ndërhyrjeje në Kushtetutë, kur ka qëllim të mirë, është e mirëpritur, por ngutja shpeshherë çon ujë në të kundërt të këtij procesi dhe qëllimit të mirë që ka vetë nisma.

U tha këtu nga kolegu im i opozitës që janë 66, ose 61 institucione arsimore të arsimit të lartë të Shqipërisë dhe ftesës së Kuvendit i janë përgjigjur vetëm 8. Në fakt, për të qenë të qartë, ne kemi ftuar vetëm ata përfaqësues të botës akademike dhe universitare që kanë fakultetet dhe departamentet e duhura për të dhënë mendime juridike dhe kushtetuese të pjekura lidhur me nismën e paraqitur nga opozita. Pra, nuk është e vërtetë që Kuvendi ka ftuar 66 institucione të arsimit të lartë, por ka ftuar universitetet. Ndërkohë, siç e sqaroi edhe Kryetari i Kuvendit, ne do të zhvillojmë diskutime, sipas kalendarit që kemi miratuar në këtë Këshill, edhe me universitetet jashtë Tiranës, që citoi Kryetarit i Kuvendit, pse jo na intereson të dimë edhe mendimin e studentëve të fakulteteve të drejtësisë. Ne jemi të hapur për komente, sugjerime dhe opinione edhe nga profesionistë të fushës, që jo domosdoshmërisht janë të lidhur me botën akademike dhe universitetet. Ne jemi të hapur edhe për studentë të ekselencës, që ndodhen jashtë Republikës së

Shqipërisë, për të dhënë mendimet dhe opinionet e tyre, sepse nuk kemi ngutje në këtë proces. Ne kemi thënë, që në krye të herës, se kemi një kuadër kushtetues dhe ligjor, që merr në konsideratë pastrimin e politikës dhe administratës shtetërore, që është ligji i dekriminalizimit. Këtë nismë e ka propozuar opozita dhe ne e kemi marrë në konsideratë, sipas procedurave që përcakton Kushtetuta dhe Rregullorja e Kuvendit, prandaj jemi sot në këtë tryezë.

Gjithsesi, për ta mbyllur, më lejoni t'i falënderoj dhe t'i listoj institucionet, pasi dua t'ua kthejmë edhe ne respektin për ftesën që na bënë. Pra, falënderoj të gjithë profesorët dhe pedagogët e Fakultetit të Drejtësisë të Universitetit të Tiranës, që ishin pjesë e këtij diskutimi! Gjithashtu, i ftoj që në ditët në vazhdim të kemi komente të tjera shtesë prej tyre, por edhe të kolegëve të tjerë që sot, për arsye se mund të kenë qenë në auditorë për të dhënë leksione, nuk ishin sot pjesë e kësaj tryeze.

Falenderoj Universitetin European të Tiranës; kolegjin universitar “Luarasi”; universitetin “Marin Barleti”, Universitetin Mesdhetar të Shqipërisë; universitetin “New York” të Tiranës; kolegjin universitar “Wisdom” dhe Institutin për Politikat Publike dhe Mirëqeverisjen.

Shumë faleminderit të gjithë përfaqësuesve të këtyre institucioneve akademike dhe universitare, që ishin sot prezent në këtë tryezë!

Edhe një herë shumë faleminderit për bashkëpunim dhe për konsultimin e vazhdueshëm, që Kuvendi ka konsoliduar me botën akademike dhe universitare, që me reformën në drejtësi, të cilën shpresoj ta vazhdojmë edhe në të ardhmen!

Faleminderit dhe ditë të mbarë!

MBYLLET MBLEDHJA